

#INNO4EDU

Titulli i aktivitetit

Koala

Mosha

Periudha zhvillimore (nga mosha 5 deri në 10 vjeçe)

Hapësira / lokacioni

Kushte shtëpie

Vlera e karakterit

Saktësi

Koha e nevojshme për përgatitje

10 minuta

Koha e nevojshme për realizim

20-25 minuta

Qëllimet

Qëllimi është që tek fëmija të zhvillohet motorika fine.

Rezultatet e pritshme

Fëmija i koordinon me saktësi lëvizjet e dorës dhe gishtat.

Kahje

Përgatitje paraprake për aktivitet

Përgatitje e letrës për kolazh dhe skemë për punimin e koalës.

Instrukcione/kahje për lojën

- Pjesën e ngjyrosur të letrës për kolazh me ngjyrë kafeje përthyejeni përgjysmë në mënyrë diagonale;
- përthyejeni një nga këndet e sipërme teposhtë, siç është dëftuar në shembull (shtesa nr. 2);
- tani përthyejeni pjesën tjetër teposhtë;
- filloni t'i sajoni veshët e koalës suaj me përthyerjen përpjetë të njërit kënd pas tjetrit, siç është dëftuar;
- tani përthyejeni edhe pjesën tjetër nga jashtë;
- përthyeji veshët me mbipalosje të skajeve;



- formojeni kokën me mbipalosje të këndit të sipërm teposhtë në modelin tuaj deri sa nuk barazohet me veshët;
- formojeni kokën me rrotullim të pjesës së poshtme të njëres anë, siç është dëftuar;
- pastaj përthyejeni anën tjetër që të formohet mjekra;
- përmbyseni modelin nga ana tjetër dhe shtojini sytë dhe hundën (mund të vizatohen ose të priten nga letra për kolazh me ngjyrë të zezë).

Aktivitet/lojë

Teksa shikohet videoja nga vegza në shtesë, me fëmijët bisedohet për koalën si kafshë e mbrojtur në Australi. Pastaj fëmija ka për detyrë të punojë Koalë sipas instruksioneve të dhëna, por nëse ka nevojë për ndihmë mund ta punoni bashkërisht. Pasi të punohet koala fëmijës mund t'i propozoni të trillojë një përrallë ose lojë dramatike.

| Shtesa | Materiale |
|---|---|
| <p><u>Shtesa nr. 1</u></p> <p>https://www.youtube.com/ëatch?v=vvmMxju9xNE</p> <p><u>Shtesa nr. 2</u></p> <p>Skemë për koalë origami</p> | <ul style="list-style-type: none"> • Letër për kolazh; fllomasterë/mgjyra. |
| Aktiviteti është përgatitur nga: | |
| <p>Edukatorë: Sonja Çallovska, Vesna Peceva</p> <p>Dizajn grafik: Katerina Nikolovska</p> <p>Lekturë: Jana Mihajlovska</p> <p>Përkthim: Agim Leka</p> | |



Origami KOALA

Kjo koalë shumë simpatike është një model i thjeshtë për punim të mëvetësishëm.

Mund të bëni koalë nga letra për kolazh: përdorni letër kolazhi ngjyrë kafeje për të prerë trung druri dhe letër ngjyrë të gjelbër për t'i prerë gjethet e eukaliptit. Ngjitni këto pjesë në një letër kolazhi me ngjyrë të kaltër.




1



Pjesën e ngjyrosur të letrës ngjyrë kafeje përthyeje për gjysmë në mënyrë diagonale.

2




Pëthyeje një nga këndet e sipërme teposhtë, siç është dhënë në shembull.

3



Tani përthyeje anën tjetër teposhtë.

4



Fillo t'i formosh veshët e koalës tënde me përthyerjen e njërit me një kënd përjetë, siç është shpërfaqur.


5



Tani përthyeje edhe pjesën tjetër nga jashtë.


Origami KOALA 2

6



Përthyeji veshët me palosjen e skajeve.

7




Sajoje kokën me palosje të këndit të sipërm të modelit tënd teposhtë, deri sa të barazohet me veshët.

8



Sajoje kokën me rrotullim të pjesës së poshtme të njërës anë, siç është dhënë në fotografi.

9



Pastaj përthyeje anën tjetër që të formohet mjekra.

10



Përmbysë modelin nga ana tjetër dhe shtoji sytë dhe hundën (mund t'i vizatosh ose t'i presësh nga letra e zezë për kolazh).

